

MANUAL PËRDORIMI – COOLER (AIR & AIO)

1. QËLLIMI I DOKUMENTIT

Ky manual ka karakter **informues** dhe synon të udhëzojë përdoruesin për instalimin dhe përdorimin korrekt të ftohësve të procesorit (Cooler Air dhe AIO – All-in-One Liquid Cooling).

 **Shënim:** Ky dokument nuk zëvendëson manualin zyrtar të prodhuesit. Instalimi i këtij lloji pajisje kërkon nivel të **avancuar** njohurish ose person të kualifikuar të kësaj fushe. Shitësi / importuesi nuk mban përgjegjësi për dëmtime që vijnë nga instalim i gabuar, rrjedhje lëngu (AIO), mbinxhje ose ndërhyrje jo të autorizuara.

2. PËRMBAJTJA E KUTISË

Në varësi të tipit të ftohësit, kutia mund të përmbajë: - Cooler (Air ose AIO) - Ventilatorë - Mbjatëse montimi (brackets) - Vida dhe aksesorë - Pasta termike (nëse nuk është e aplikuar) - Manual i shkurtër / kartë garancie

 Mos vazhdoni instalimin nëse mungon ndonjë pjesë.

3. NXJERRJA NGA KUTIA (UNBOXING)

1. Hapeni kutinë mbi një sipërfaqe të sheshtë.
2. Nxirrni ftohësin duke e kapur nga trupi metalik.
3. Mos e tërhiqni nga tubat (për AIO).

4. KOMPATIBILITETI

Para instalimit, sigurohuni që: - Cooler-i mbështet(përshtatet) socket-in e CPU-së - Case ka hapësirë të mjaftueshme - Radiatori (AIO) përputhet me pozicionin në case

 Instalimi jo kompatibil mund të shkaktojë dëmtime.

5. PASTA TERMIKE

- Aplikoni një sasi të vogël paste termike (nëse nuk është paraprakisht)
- Mos e shpërndani me dorë
- Në varësi të modelit të CPU, kërkohet sasi e ndryshme paste termike

 Kërko informacion për procesorin tënd nëse nuk jeni i sigurt

6. INSTALIMI I COOLER AIR

1. Vendosni mbajtëset përkatëse në motherboard.
2. Vendosni cooler-in mbi CPU.
3. Fiksioni gradualisht me vida ne menyre diagonale
4. Lidhni ventilatorin në CPU_FAN.

7. INSTALIMI I COOLER AIO (LIQUID)

1. Vendosni radiatorin në case (sipër ose përpara).
2. Fiksioni ventilatorët në radiator.
3. Vendosni bllokun (Header) mbi CPU.
4. Lidhni pompën dhe ventilatorët në motherboard.

 Pompa duhet CPU_AIO (CPU_OPT) ose latervative, FAN duhen ne CPU_FAN

 Mos e ndizni sistemin pa pompë aktive.

8. VENTILIMI DHE QARKULLIMI I AJRIT

- Siguroni hyrje dhe dalje ajri
- Mos bllokoni radiatorin ose ventilatorët

9. STARTIMI I PARË

1. Ndizni sistemin.
2. Kontrolloni rrotullimin e ventilatorëve.
3. Monitoroni temperaturat.

Nëse temperaturat janë të larta: - Kontrolloni montimin - Kontrolloni pastën termike. Në disa modele momenti i parë i ndezjes dëgjohet zhurmë qarkullimi i lëngut apo zhurmë nga pompa, e cila normalizohet pas 1-5min.

10. MIRËMBAJTJA

- Pastroni ventilatorët çdo 3–6 muaj
- Kontrolloni zhurmat e pazakonta
- Për AIO: monitoroni çdo shenjë rrjedhjeje

11. KUFIZIM PËRGJEGJËSIE

Shitësi/importuesi nuk mban përgjegjësi për: - rrjedhje lëngu nga AIO - mbinxhje nga montim i gabuar - dëmtime të CPU-së – çdo dëmtim fizik tjetër(tërthortë apo drejtpërdrejt) shkaktuar nga vidosja e tepert.

12. SHËNIME FINALE

Ky manual është i vlefshëm për shumicën e ftohësve Air dhe AIO standard.

Dokument orientues për përdorim teknik dhe shitje

Në rast se hasni vështirësi gjatë montimit dhe ju duhet ndihmë, mund të kontaktoni në çdo moment me suportin teknik gjatë orarit të punës (E Hënë – E Shtunë 10:00- 20:00) në një nga mënyrat:

TEL/Whatsapp: +355 69 6666 456

email: info@lv4tech.com

Ticket: helpdesk.lv4tech.com

Facebook DM: @LV4Tech

Instagram DM: @LV4Tech